Kronikë

Drogë, kallashnikov dhe municion luftarak, 2 të arrestuar në Dibër (EMRAT)

Dy persona kanë rënë në prangat e policisë së Dibrës, pasi në makinën që po udhëtonin iu gjet armë zjarri, municion luftarak dhe drogë

Arma, fishekët dhe drogë e sekuestruar

Redaksia
4 Shtator, 13:34 | **Përditesimi: 4 Shtator, 13:45**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Dibër-Dy persona kanë rënë në prangat e policisë së Dibrës, pasi në makinën që po udhëtonin iu gjet armë zjarri, municion luftarak dhe drogë.

Sipas njoftimit të policisë dy të rinjtë Elsi Kuca dhe Aleksandër Tota u ndaluan në fshatin Sllovë.

Kallashnikovi, 25 fishekë dhe doza kanabisi gati për shitje u sekuestruan si provë materiale.

LEXO EDHE:
Vuçiç paralajmëron blerje armësh nga Kina, kritikon fqinjët! Nuk do ta prekim askënd, por do forcojmë ushtrinë për të ruajtur integritetin territorial

Njoftimi i policisë:

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në DVP Dibër, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja" dhe Komisariatin e Policisë Dibër, në vijim të operacioneve policore me objektiv identifikimin e shtetasve që posedojnë armë zjarri, si dhe mbajnë apo shesin lëndë narkotike duke cenuar sigurinë e qytetarëve, finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Mesnata".

Si rezultat, shërbimet e Policisë, në fshatin Sllovë, kanë ndaluar automjetin tip "Peugeot", që drejtohej nga shtetasi E. K. (D), 26 vjeç, banues në fshatin BllIçë, dhe pasagjerin, shtetasin A. T., 22 vjeç, banues në fshatin Fushë-Alie.

Gjatë kontrollit fizik, 26-vjeçarit iu gjet e fshehur në trup një sasi lëndë narkotike kanabis, e ndarë në doza, gati për shitje.

Po në vijim të operacionit, shërbimet e Policisë ushtruan kontroll në banesat e këtyre dy shtetasve, ku, në banesën e shtetasit A. T., u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një armë zjarri kallashnikov dhe 25 copë fishekë, të cilët i mbante pa leje.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

E. K. (D), për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike".

A. T., për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve luftarake".

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: drogë arme Aleksandër Tota Elsi Kuca Dibër

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 4 Shtator, 18:18

A jeni dakord me propozimin e Ramës për heqjen e depozitave të ujit nga pallatet?

Po Jo Nuk kam mendim

Lajme të tjera



SHBA fundos skafin pranë Venezuelës, vdesin 11 trafikantë! Trump: Po sillnin drogë në vendin tonë (VIDEO)
3 Shtator, 08:06

Mausoleumi gjigand i periudhës romake në Bulqizë! Arkeologu për Report TV: Materialet e përdorura dhe mbishkrimet e gjetura, tregojnë se ka qenë vendbanim i aristokratëve
Mahir Jangulli
2 Shtator, 15:00

I ndërtuar afro 2400 vite më parë dhe i pari i këtij lloji në Shqipëri, zbulohet në Bulqizë varri monumental i periudhës romake (FOTOT)
2 Shtator, 10:01

Itali/ Shiste drogë ndërsa ishte në arrest shtëpie, pranga 40-vjeçarit shqiptar
1 Shtator, 19:56

Kapen mat me një çantë me 675 gramë kanabis, pranga dy të rinjve në Kamëz! Do e shisnin në Tiranë (VIDEO)
1 Shtator, 09:53

Bulqizë/ Bëri vetëgjyqësi dhe nuk lejoi administratoren e minierës të hynte në galeri, nën akuzë 50-vjeçari nga Tirana!
29 Gusht, 13:36

Zjarri përpin çatinë e pallatit trekatësh në Peshkopi, panik te banorët! Dëme të shumta materiale (VIDEO)
27 Gusht, 08:55

Tre makina përplasen në aksin Bulqizë-Fushë Bulqizë (VIDEO)
24 Gusht, 11:35



Vlorë/ Drogë, armë, thyerje mase dhe sherr, 2 të arrestuar dhe 3 persona të tjerë nën akuzë brenda pak orëve!
23 Gusht, 10:48

Italia e kërkon për vjedhje, arrestohet 22-vjeçari në Bulqizë (VIDEO)
22 Gusht, 09:32

Ortodoksë dhe myslimanë bëhen bashkë për mbrojtjen e kishave në Dibër
Sami Curri
21 Gusht, 16:41

Po kthehej nga Greqia, prangoset në Kakavijë 43-vjeçari i dënuari me 40 muaj burgim për drogë!
21 Gusht, 12:24

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje